



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008, të nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b**, nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.05.2022, miratoi këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Vendimi për shfuqizimin e pjesërishëm të Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-0088887/20, i dt. 11.06.2020.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, shfuqizohet pika 7 e nenit II të vendimit të lartcekur, respektivisht programi i granteve për biznese, të vetpunësuarit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për ndihmë ndaj bizneseve, të cilët kanë dëshmuar humbjet e shkaktuara nga masat restriktive.
- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-143947/21, i dt. 22.07.2021.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-103541/22, më 12.05.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

